



European
Union
Kosovo


Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World


 HEINRICH
BÖLL
STIFTUNG

Empower Engage Build Ownership

Implementuar nga:

 **balkan
green**
foundation

 **INDEP**
INSTITUTI QENDRORE
PËR DEKORIMIN DHE
PËRZEMBEJESIN



RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Profili i projektit:	Forcimi i kapacitetit të OSHC-ve
Kohëzgjatja e projektit:	36 muaj
Implementuar nga:	Balkan Green Foundation (BGF) dhe Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP
Financuar dhe menaxhuar nga:	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
Lokacioni i organizatave partnere:	Në tërë rajonin e Kosovës

PËRMBAJTJA

Rreth Projektit	4
I. Fazat e projektit	5
II. Komponenta e parë: Raporti i Vlerësimit	6
III. Komponenta e dytë: Skema e grantit	8
III.1. Sesionet informuese mbi skemën e granteve	10
III.2. Procedura e aplikimit dhe shqyrtimit	11
III.3 Monitorimi dhe Konsulenca	12
III.4. Platforma e Komunikimit	13
III.5. Raporti Përfundimtar	13
III.6. Veprimet konkrete: Grantet operacionale dhe programet për OShC-të	14
IV. Komponenta e tretë: Trajnimet për ngritjen e kapaciteteve	18
V. Komponenta e katërt: Ngjarja promovuese	20
V.1. Rritja e ndërgjegjësimit	22
VI. Rezultatet e veprimit	23
VII. Progresi në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë	24
Shtojca A: Lista e organizatave përfituese të skemës së nën-dhënies Empower-Engage-Build Ownership	25
Shtojca B: Trajnimet dhe sesionet informuese	28
Shtojca C: Fotografitë me përfituesit e granteve	31
Informacione bazë mbi partnerët e implementimit	34
Mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë për Projektin EEBO	35

RRETH PROJEKTIT

Balkan Green Foundation dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ishin përfitues të Grantit për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile dhe Iniciativat e Mediave përmes të cilit implementuan projektin "Empower-Engage-Build Ownership", me qëllim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë duke u përqëndruar në tri tema prioritare: *Mjedisi, Energjia dhe Rritja e Gjelbër Ekonomike*.

Objektivi i përgjithshëm i këtij veprimi ishte t'i mundësojë sektorit të shoqërisë civile në Kosovë të përmbushë rolin e tij në mjedisin demokratik duke vepruar si bashkëbisedues të pavarur, duke monitoruar institucionet publike, duke rritur llogaridhënien dhe transparencën në zhvillimin e politikave dhe proceset e vendimmarrjes, në lidhje me shqetësimet e komuniteteve grupet e shoqërisë civile në fushën e ruajtjes së mjedisit, energjisë së gjelbër dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1:

Përmirësimi i aftësive dhe ndarjes së informacionit të OSHC-ve për monitorimin e politikave, avokimin dhe kampanjave për temat e synuara me prioritet.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2:

Rritja e incentivës për të përmirësuar pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikëbërje dhe zbatim të politikave, avokimin dhe aktivitete përmes financimit të organizatave në të gjithë Kosovën.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3:

Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë përmes mbështetjes së aktiviteteve që veçanërisht promovojnë ruajtjen e mjedisit, energjinë e gjelbër dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike.

GRUPET E SYNUARA:

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Mundësi për të siguruar fonde, njohuri të zgjeruara të OShC-ve dhe kapaciteteve të tyre profesionale në tri temat me përparësi veprimi

AUTORITETET PUBLIKE

Mundësi e përfshirjes dhe bashkëpunimit me OShC-të në nivelin politik, ndërsa promovohet përfshirja e OShC-ve në vendimmarrje publike

POPULLËSIA E PËRGJITHSHME

Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe opsionet e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë.

Me pak fjalë, projekti synoi të theksojë se shoqëria civile duhet të ketë rol dhe mbështetje të domosdoshme në mënyrë që të jetë në gjendje të angazhohet dhe të përmirësojë situatën e shoqërisë - e arritur përmes koordinimit proaktiv, bashkëpunimit, rrjetëzimit me të gjithë palët e interesit.

I. FAZAT E PROJEKTIT

"Empower-Engage-Build Ownership" u krijua me konceptin e ofrimit të mundësive për rritje të gjelbër ekonomike, ruajtjen e mjedisit, përdorimit efikas të energjisë dhe shëndet më të mirë të njeriut. Kështu, projekti u nda në katër komponente kryesore:

Raporti i Bazuar në të Dhëna i 7 qendrave kryesore administrative në Kosovë, i cili identifikoi nevojat më të mëdha në tri temat më me prioritet të këtij veprimi.

Ndarja e njohurive teknike për aktivistë të tjerë të OSHC përmes Trajnimeve për Ndërtimin e Kapaciteteve.

Paralelisht, një Program Gjithëpërfshirës i Nën-Granteve u njoftua dhe iu dha OShC-ve për të gjetur dhe prezantuar zgjidhje për përparësitë dhe nevojat e komuniteteve lokale ku ata punojnë. Skema e nën-granteve gjithashtu ndihmoi për të çuar përpara politikat që kontribuan në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetin në sektorët e synuar.

Për më tepër, organizatat partnere organizuan ngjarje që mbledhën akterët e rëndësishëm të sektorit për të identifikuar përparësitë dhe për të promovuar arritjet nga aktivitetet.



II. KOMPONENTA E PARË: RAPORTI I VLERËSIMIT

Raporti i Vlerësimit Bazë u krye nga ekipet e BGF dhe INDEP i cili dha një pasqyrë të gjendjes aktuale të çështjeve për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë, duke u përqëndruar në tre fusha:

1. PRANIA E PËRGJITHSHME E OSHC-ve,
2. PRANIA INSTITUCIONALE DHE,
3. ZONAT ME POTENCIAL ZHVILLIMOR.

Më saktësisht, raporti u realizua me këto objektiva të përgjithshëm:

1. *Ofrimi i një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes në situatën bazë të OSHC-ve në Kosovë, për t'u përdorur si referencë për krahasimin e rezultateve të arritura përmes ndërhyrjeve (trajtime, grante dhe veprime të tjera) dhe objektivin e vlerësimit të ndikimit dhe kontributit të tyre në përmirësimin e situatës fillestare.*

2. *Ofrimi i informatave dhe të dhënave. Vlerësimi bazë identifikoi fushat ndërhyrëse në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe planin e punës të nevojshëm për të përmirësuar situatën.*

3. *Identifikimi i akterëve kryesorë të cilët punojnë në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë dhe fushat tematike të punës dhe projekteve me potencial për mbështetje përmes skemës së nën-granteve.*

4. *Paraqitja e rekomandimeve mbi veprimet e palëve të interesit rreth zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë.*



Fig 1. Raporti i Vlerësimit

Raporti i Vlerësimit shfaq një pasqyrë të qartë të problemeve të Kosovës në tri temat me prioritet të këtij veprimi dhe rekomandimet për këto fusha specifike, por gjithashtu shërbeu si një udhëzues për Kosovën për të përmirësuar zhvillimin e saj socio-ekonomik. Raporti përdori të dhëna cilësore dhe sasore, duke aplikuar një qasje gjithëpërfshirëse, ku të gjithë akterët relevantë janë intervistuar në mënyrë që të ketë rekomandime të strukturuar mirë dhe të sakta. Për hartimin e këtij raporti është përdorur metodologjia e mbledhjes së informatave nga palët e interesit përmes intervistave të realizuara, pyetësorëve dhe hulumtimeve të kryera.

Raporti shërbeu si një udhëzues për identifikimin e prioriteteve specifike në secilin rajon të Kosovës, për sektorin e zhvillimit të qëndrueshëm bazuar në nevojat specifike të grupeve të synuara dhe përfituesve përfundimtarë. Për më tepër, shërbeu si një burim kryesor për përpilimin e udhëzimeve për programin e trajnimit për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe identifikimin e veprimeve të pranueshme të zbatuara përmes programit të nën-granteve. Raporti i Vlerësimit shërbeu si bazë për projektin - si një fazë përgatitore që është e rëndësishme për hapat e ardhshëm të veprimit.

Rekomandimet e mëposhtme janë bazuar në analizat hulumtuese dhe janë përqëndruar gjerësisht në veprimet e mundshme të OShC-ve, ndërhyrjet e nevojshme në kornizën legislative dhe harmonizimin e kompetencave. OShC-të duhet të zbatojnë veprime konkrete dhe të përcaktuara mirë që përputhen me qëllimin e tyre për të punuar. OShC-të duhet të ndjekin një qasje proaktive në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë e saj dhe zbatimin e aktivitetit të lirë me qëllim të organizimit të një strategjie afatgjate dhe përcaktuese. Nëse disponueshmëria e fondeve është e vogël, OShC-të inkurajohen të veprojnë në mobilizimin e komuniteteve të tyre për punë vullnetare dhe gjithashtu të konsiderohet krijimi i koalicioneve tematike për të adresuar bashkarisht problemet e bazuara në komunitetin me partnerët e tjerë që veprojnë në të njëjtën fushë.

Zhvillimi i një profili organizativ dhe rekrutimi i fuqisë punëtore

Shumë OShC punojnë me plan veprimi afatshkurt, kjo formë e veprimit mund të krijoj implementim të aktiviteteve të njehta nga organizata e tjera. Për të shmangur probleme të tilla, është e rëndësishme që OShC-të të përcaktojnë profilin e organizatës si dhe të përqendrohen në rekrutimin e fuqisë punëtore kompetente, e cila do të ndihmojë në avancimin e shkaqeve për të cilat ata qëndrojnë.

Përcaktimi i kompetencave të nivelit lokal dhe qendror

Niveli qendror dhe komunal rishikojnë politikat aktuale dhe kompetencat e tyre të deleguara për të shmangur mbivendosjen e përgjegjësiave për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në vend. Kjo nga ana tjetër do të rrisë nivelin e përgjegjësisë institucionale.

Futja e mekanizmave të qëndrueshëm të financimit për të mbështetur veprimet e lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm

Qeveria duhet t'i japë përparësi prezantimit të Fondit të Gjëlber / Eko. Ky fond, për dallim nga grantet e paqëndrueshme afatshkurtra dhe kreditë shumë të rënda financiare, do të rrisë investimet në veprime të gjëlbera nga OShC-të, bizneset apo edhe familjet drejt promovimit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Koordinimi i prezantimit të fushatave vetëdijësuese

Përkundër numrit relativisht të madh të fushatave individuale vetëdijësuese për zhvillimin e qëndrueshëm, vetëdijësimi tek qytetarër për këto tema vazhdon të jetë i ulët. Si i tillë, nevoja për bashkëpunim sistematik dhe koordinim të mirë ndër-institucional / organizativ luan rol të rëndësishëm për të kuptuarit e koncepteve të SD për publikun dhe të gjitha grupet e interesit.

¹ https://www.balkangreenfoundation.org/uploads/files/2020/December/02/Final_Evidence_Based_Report_EEBO_eng1606913648.pdf

III. KOMPONENTA E DYTË: SKEMA E GRANTIT

Thelbi i projektit EEBO ishte skema e nën-granteve, përmes së cilës u mbështetën financiarisht gjithsej 59 projekte ide të zbatuara nga OShC-të lokale, me një shumë prej rreth 355,000 EUR. OShC-të u vlerësuan me mbështetje financiare pas një procesi të kujdesshëm të dhënies së granteve i cili përfshinte shpalljen e thirrjes për propozime, sesione informuese, procedurën e shqyrtimit të aplikacioneve nga komiteti i ekspertëve, nënshkrimin e kontratave të granteve, shpërndarjen e granteve, trajnimet për ndërtimin e kapaciteteve, monitorimin e zbatimit të projekteve të planifikuara, mbështetjen e konsulencës gjatë fazës së zbatimit dhe dorëzimin e raportit përfundimtar.

Skema e nën-granteve siguroi mbështetje financiare për OShC-të, për projektet që adresojnë problemet më urgjente në sektorët e synuar: mjedisi, energjia dhe rritja e gjelbër ekonomike. Si i tillë, në fushën e energjisë, OShC-të zbatuan projekte në lidhje me promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, efikasitetin e energjisë, inovacionin dhe integrimin në energji. Lidhur me mjedisin, vëmendje e veçantë iu kushtua projekteve inovative që synuan rritjen e mbrojtjes së mjedisit, me një fokus të veçantë në cilësinë dhe rehabilitimit të tokës, dhe projekte të vetëdijësisë. BGF dhe INDEP gjithashtu mbështetën projekte që synuan futjen e ekonomisë qarkore dhe promovimin e rritjes së ekonomisë së gjelbër, si dhe ndihmën e OShC-ve të specializuara në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në përgjithësi.

Shpërndarja e granteve për OShC të ndryshme në Kosovë rezultoi në përfshirjen e një audience më të gjerë dhe më të larmishme gjatë gjithë periudhës së implementimit të projektit. Në secilën thirrje për propozim, partnerëve të projektit u dhanë tre grante të mesme deri në 15,000 EURO dhe afërsisht 17 organizata, grante të vogla, që variojnë nga 3,500 deri në 5,900 Euro.

THIRRJET E HAPURA (GJITHSEJ 3)	NUMRI I GRANTEVE TË VOGLA TË MBËSHTETURA (SHUMA PREJ 5000 - 5900 EUR)	NUMRI I GRANTEVE TË MESME TË MBËSHTETURA (DERI NË 15,000 EUR)
Thirrja e parë	16	3
Thirrja e dytë	17	3
Thirrja e tretë	17	3
Total:	50	9

Nga 2018 në 2020, tri thirrje propozuese u hapën për të mbështetur grante të vogla dhe të mesme, duke ftuar të gjithë OShC-të e interesuara të aplikojnë për fonde në implementimin e projekteve të organizuara në Kosovë në lidhje me temat e lartëcekura. Thirrja për propozime shërbeu si një mjet për të marrë aplikime / propozime nga OShC-të, duke siguruar sqarime të përgjithshme sipas kriterëve të përcaktuara për aplikim, shumën minimale dhe maksimale të fondeve të përshkruar sipas thirrjes së hapur, objektivat e thirrjes, temat dhe përparësitë për financim, afatin kohorë të aplikimit, afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për sqarime, dhe afatet për ofrimin e sqarimeve dhe afati i fundit për dorëzimin e propozimit.



Fig 2: Shpallja e Thirrjes për Aplikime

Thirrja për aplikime dhe dorëzim të dokumenteve të nevojshme për aplikim është publikuar faqet e internetit të partnerëve të projektit – www.balkangreenfoundation.org ; www.indep.info , ndërsa dokumentet e aplikimit u shpërndanë gjithashtu edhe gjatë sesioneve informuese. Thirrjet gjithashtu u lansuan dhe u botuan në Portalin për Financim në Kosovë, dhe gjithashtu tek platformat e rrjeteve sociale të partnerëve përkatës.



III.1. SESIONET INFORMUESE MBI SKEMËN E GRANTEVE

Pas botimit të secilës thirrje të hapur për propozime, BGF dhe INDEP zhvilluan sesione informuese në 7 rajone të Kosovës (Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren). Në këto sesione, thirrja për propozime u përpunua dhe diskutua publikisht. Gjatë këtyre sesioneve informuese, përfaqësuesit e partnerëve të projektit informuan pjesëmarrësit në lidhje me procedurat e aplikimit, duke siguruar udhëzime për aplikim dhe forma të buxhetit për sa i përket rregullave administrative dhe teknike. Më tej, të dhënat u ndanë sipas secilit kriter dhe kushteve përkatëse që duhet të plotësoheshin, para dhe gjatë procesit të aplikimit. Pjesëmarrësit mësuuan procedurat e hollësishme të përgjithshme teknike dhe administrative të thirrjes, në formularin aplikues dhe morën njohuri të përgjithshme mbi terminologjinë, mbi koncepte të tilla si: Energjia e Gjelbër, Ekonomia Qarkore etj.



Fig. 3: Takimet e sesionit informues

Pas çdo prezantimi, një sesion u kushtojë pyetjeve dhe përgjigjeve, ku secili pjesëmarrës kishte mundësinë të bënte pyetje ose të kërkonte sqarime që ishin të zbatueshme për organizatën e tyre ose idenë e projektit.

- a) Sesionet informuese për thirrjen e parë për aplikime u zhvilluan ndërmjet **5-14 qershor 2018** në 7 rajone të Kosovës (Ferizaj, Gjakovë, Gjiilani, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren).
- b) Sesionet Informative për Thirrjen e Dytë për Aplikime u mbajtën në një afat kohor ndërmjet datave **18-28 mars, 2019**. Me kërkesë të Zyrës së BE-së në Kosovë, dhe duke marrë parasysh interesin që mori kjo thirrje në të gjithë audiencën e gjerë, BGF dhe INDEP organizuan një sesion informues më shumë në Mitrovicën e Veriut.
- c) Sesionet informuese për thirrjen e tretë për aplikime u mbajtën në një afat kohor ndërmjet datave **2-11 tetor 2019** në 7 rajone të Kosovës (Ferizaj, Gjakovë, Gjiilani, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren).




Tabela 1. Sesionet informuese mbi Skemën e Nën-Granteve

III.2. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE SHQYRTIMIT

Të gjitha thirrjet për aplikime ishin të hapura për afro 15 ditë. Gjatë kësaj periudhe, u pranuan aplikime nga organizata të ndryshme. Aplikimet e paraqitura përmes postës elektronike u mbledhën të gjitha nga koordinatori i projektit dhe u përgatitën për shqyrtim nga komisioni i vlerësimit, të cilin ishin përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve të paraqitura. Në procesin e klasifikimit është bërë ndarja e aplikacioneve që plotësojnë kriteret teknike dhe atyre që nuk kanë plotësuar kriteret e paraqitura, BGF dhe INDEP krijuan listën e aplikimeve të kualifikuara për fazën e dytë vlerësuese. Pas fazës së parë të klasifikimit, aplikimet e vlefshme u klasifikuan nga komisioni vlerësues, i cili vlerësoi propozimet e marra për meritat e ideve, objektivave dhe aktiviteteve të propozuara.

Komisioni i vlerësimit përbëhej nga tre deri në katër anëtarë - përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile të Kosovës (të paktën një me përvojë në dhënie të granteve), dhe një anëtar me përvojë të dëshmuar në çështje të zhvillimit të qëndrueshëm që mund të punojnë në Kosovë, rajon ose ndërkombëtarisht. Mbikëqyrur nga koordinatori i projektit dhe menaxheri i grantit, Komisioni Vlerësues kishte tre deri në katër ditë në dispozicion për të shqyrtuar aplikimet, të cilat i u nënshtruan të njëjtit proces shqyrtimi dhe u vlerësuan në bazë të një fletë vlerësimi të standardizuar.

Kriteret për zgjedhjen e propozimeve të projekteve për përfitim të grantit u ndanë në katër kategori:

- Rëndësia e veprimit duke i kushtuar prioritet temave kryesore
- Kreativiteti i fuqishëm në përmbajtje dhe gjatë aktiviteteve
- Strategjia komunikuese dhe ndikimi i saj
- Cilësia e ofertës financiare



III.3 MONITORIMI DHE KONSULENCA

Menjëherë pas nënshkrimit të kontratave dhe shpërndarjes së granteve, OShC-të filluan të implementojnë projektet e tyre përkatëse. Për secilën prej thirrjeve, partnerët e projektit ishin në terren dhe vizituan të gjithë përfituesit për të monitoruar aktivitetet e projektit dhe për të parë nëse OShC-të po përballeshin me ndonjë vështirësi të madhe në këtë drejtim. Qëllimi i këtyre vizitave ishte të kontrollohej progresi që organizatat kishin bërë në lidhje me zbatimin e projekteve të tyre përkatëse, të kontrolloheshin sfidat e mundshme dhe gjithashtu të rishikohehin praktikatat e menaxhimit financiar. Çdo vizitë u nda në dy seksione: 1) rishikimi i progresit në lidhje me planin e punës dhe 2) rishikimi i praktikave financiare.



Këto vizita ndihmuan vëzhgimin nga afër të gjitha projektet dhe krijuan mundësinë për të bashkëpunuar edhe një herë nga afër me OShC-të të cilët deklaruan se ishin shumë të kënaqur me faktin që iu dha kjo mundësi.

Vlen të përmendet se duke marrë parasysh pandeminë COVID-19 dhe kufizimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, BGF dhe INDEP zgjodhën "Monitorimin Online" si opsionin e vetëm në dispozicion për të kryer monitorimin e grantistëve të thirrjes së tretë - kjo me qëllim për të ndihmuar grantet në zbatimin e tyre të projektit. Një faqe "Monitorimi Online" u hartua nga BGF dhe INDEP, e cila iu përcoll të gjithë përfituesve. Objektivi i këtij monitorimi ishte të kontrollohej progresin që organizatat kanë bërë në lidhje me zbatimin e projekteve të tyre përkatëse, të shpaloseshin sfidat e mundshme në zbatim gjatë COVID-19, të rishikoheshin planet, aktivitetet e kryera dhe gjithashtu të analizoheshin praktikatat e menaxhimit financiar që organizatat kanë përdorur deri më tani.

Ekipet e BGF dhe INDEP kanë ofruar vazhdimisht këshillim dhe ndihmë praktike për grantistët për vizibilitet, menaxhim, rrjetizim, udhëzime dhe çdo ndihmë tjetër praktike që mund të kërkohej gjatë zbatimit të secilit grant. Gjatë zbatimit të projekteve të tyre, të gjithë grantistët, nga grantet e mesme dhe përfituesit e granteve të vogla, ishin në kontakt me partnerët e projektit, dhe të paktën një nga aktivitetet e tyre u monitorua fizikisht nga ekipi i projektit. Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, gjithashtu është ofruar mundësia për të gjithë përfituesit të na konsultojnë dhe të vizitojnë zyrat tona ose të kërkojnë ndihmë për çfarëdo problemi që lind gjatë zbatimit të projektit në mënyrë që të sigurohet rrjedhja e qetë e projekteve.

Si përmbledhje, BGF dhe INDEP kanë bërë çmos për të ndihmuar të gjitha organizatat përfituese gjatë zbatimit të projektit të tyre dhe për të siguruar ndihmë në mënyrë që këto organizata të rriten dhe të përparojnë.

III.4. PLATFORMA E KOMUNIKIMIT

Një pjesë e rëndësishme e projektit ishte krijimi i një platforme gjithëpërfshirëse të komunikimit, e organizuar për komunikim dhe bashkëpunim ndërmjet organizatave fituese të granteve nga e gjithë Kosova. Platforma përmban informacione për të gjitha OShC-të përfituese brenda veprimit, duke shërbyer si një mjet komunikimi dhe bashkëpunimi midis të gjithë përfituesve të granteve edhe pas përfundimit të projektit. Për më tepër, platforma do t'u shërbejë organizatave zbatuese BGF dhe INDEP si një bazë të dhënash të OShC-ve, për ngjarje dhe mundësi bashkëpunimi që mund të krijohet në të ardhmen. Kjo platformë e shkëmbimit të informacionit është një mjet ndihmës për OShC-të për të përqafuar bashkëpunimin dhe përdorimin e rrjetit si çelës për arritjen e ndikimit në komunitet në përgjithësi.




Fig 4. Platforma e komunikimit

III.5. RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë përfituesit ishin përgjegjës të përpilonin Raportin Përfundimtar përmes postës elektronike një muaj pas përfundimit të projektit të tyre. Raporti përfshinte një raport tregues i cili duhet të dorëzohej së bashku me faturat si dhe fotografi të aktiviteteve të tyre gjatë projektit, në mënyrë që të matnin dhe siguronin prova mbi rezultatin e arritur.



III.6. VEPRIMET KONKRETE: GRANTET OPERACIONALE DHE PROGRAMET PËR OSHC-TË

Mbështetja financiare është jashtëzakonisht e rëndësishme për të gjitha OShC-të, pavarësisht nga konteksti gjeografik në të cilin veprojnë. OShC-të i finalizuan aktivitetet e tyre në rajone dhe komunitete të ndryshme përreth Kosovës. Për më tepër, projekti mori në konsideratë shtrirjen e OShC-ve të vogla, dhe ato të drejtuara nga pakica dhe / ose gra - duke marrë parasysh se pengesat për rritje për kategori të tilla janë veçanërisht të theksuara. Duke përkushtuar një program që mbështet OShC-të me projekte të vogla dhe të mesme, ne ndihmuam më shumë OShC-të që të bëhen pjesëmarrës të plotë në çështjet që lidhen me përmirësimin e komunitetit. Prandaj, jetëgjatësia dhe thellësia e mbështetjes për qëllimet, kontributet dhe angazhimet e OShC-ve të mbështetura në projekt dëshmuon të jenë të domosdoshme.




Tabela 2. Lista e përfituesve të granteve në secilën komunë

Projektet e mbështetura kanë përfshirë aktivitete të tilla si:

- Trajnime gjithëpërfshirëse për temat prioritare
- Punëtori krijuese mbi ekonominë qarkore me fëmijë, gra dhe të rinj
- Pjesëmarrje në zhvillimin e politikave publike
- Fushata të ndërgjegjësimit
- Teknologji inovative me fokus në energjinë solare
- Debate dhe diskutime të hapura me qytetarë dhe ekspertë
- Gjelbërim dhe pastrim i hapësirave

SHEMBUJ TË DISA PREJ PROJEKTEVE TË SUKSESSHME TË GRANTEVE ME NDIKIM NË KOMUNITET

Thirrja e parë:

DOKUFEST (GRANT I MESËM) - ME KINEMANË SOLARE

Kinemaja e parë solare udhëtuese në Kosovë, një kinema e lëvizshme me energji solare, e cila përqipet të rrisë qasjen në kinema, të rrisë ndërgjegjësimin dhe të theksojë rëndësinë e kalimit në energjitë e ripërtitshme. Kjo ka mundësuar shfaqjen e filmave në hapësirat publike si dhe parqe dhe kënde lojërash në lagje, komunitete rurale etj.



Fig. 5 Shembull i një prej projekteve të suksesshme të granteve me ndikim në komunitet - Kinema Diellore

Jakova Innovation Center (Grant i vogël) – Smart Bin në Komunën e Gjakovës

Projekti 'Smart Bin', i implementuar në mbështetje të ngushtë me Komunën e Gjakovës, kishte për qëllim stimulimin e qytetarëve për të hedhur mbeturina në vendin e caktuar në këmbim të Wi-Fi falas për 15 minuta.

Video: <https://www.youtube.com/watch?v=guLUaZAgP3Q>



Fig 6. Shembull i një prej projekteve të suksesshme të granteve me ndikim në komunitet - Smart Bin

Thirrja e Dytë (filloi të zbatohet nga korriku 2019)

WOMEN'S BUSINESS ASSOCIATION (SHE-ERA) (GRANT I MESËM) – me 'Prodhimi i plehut organik me konceptin e ekonomisë qarkore si një burim i sigurt i qëndrueshëm në Kosovë'

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte promovimi dhe ndërgjegjësimi i grave fermere për shfrytëzimin e një mbetje të biodegradueshme në mënyrë që të prodhohej pleh organik. Objektivi specifik është prodhimi i plehut organik me konceptin e ekonomisë qarkore si një burim i qëndrueshëm i sigurt në Kosovë. Projekti u implementua në komuna të shumta si: Gjakovë, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë Veri / Jug.



Fig 7. Shembull i një prej projekteve të suksesshme nën-dhënie me ndikim në komunitet - Plehrat Organike

AYA PJETER BOGDANI (GRANT I MADHËSISË SË VOGËL) - "BIÇIKLETAT, QYTETI DHE UNË"

Idea e projektit kontrobuoi në ndryshimin e sjelljes së qytetarëve në lidhje me mjedisin, duke ndryshuar praktikat e tyre të transportit / ngasjes në favor të biçikletave. Duke u përqëndruar në promovimin e shembujve të mirë, projekti synoi gjithashtu të sigurojë platforma të çiklizmit për të gjithë të interesuarit në mënyrë që aktivitete të tilla të mos jenë vetëm individuale, por të inkurajuar një masë më të madhe të çiklizmit në vend.



Fig 8. Shembull i një prej projekteve të suksesshme të sub-granteve me ndikim në komunitet 'Biçikletat, qyteti dhe unë'

Thirrja e tretë: (filloi të zbatohet nga shkurti 2020)

FREE LIBRE OPEN SOURCE SOFTWARE KOSOVA (FLOSSK) (GRANT I MESËM) - Marrja e të dhënave mjedisore për ndërgjegjësimin për klimën dhe cilësinë e ajrit "Sensor Stations"

Projekti "Sensor Stations" i mësoi nxënësit të ndërtojnë stacionet e tyre, të krijojnë dhe analizojnë të dhëna për mjedisin, si dhe synoi të ngrisë vetëdijësimin për cilësinë e ajrit dhe ndryshimet klimatike, si dhe rritjen e veprimtarisë së shkencës qytetare në Kosovë.



Fig 9. Example of one of the successful sub-granting projects with community impact 'Sensor Stations'

VARG E VI (SMALL GRANT) - 'Healthy Walk'

Qëllimi i projektit ishte rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke mbështetur aktivitete që veçanërisht promovojnë mbrojtjen e mjedisit. Aktivitetet e projektit përfshinin: instalimin e librave ekologjike, promovimin e punimeve dhe punimeve kërkimore mbi gjendjen aktuale të ndotjes së mjedisit në rajonin e Gjilanit.



Fig 10. Shembull i një prej projekteve të suksesshme nën-grante me ndikim të komunitetit 'Shëtitje e Shëndetshme'

EEBO KA ARRITUR QË TË:

- Mbledhë mbi **5000** pjesëmarrës në aktivitete të projektit
- Angazhojë drejtpërdrejt mbi **300** organizata
- Organizojë më shumë se **80** Punëtori dhe Trajnine
- Prodhojë mbi **100** Broshura dhe Pamfleta
- Prodhojë mbi **5** Punime Kërkimore

Fig 11. Shembuj të punës së nën-përfituesve



IV. KOMPONENTA E TRETË: TRAJNIMET PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE

Një element thelbësor qendror i çdo strategjie avokimi është fuqizimi i OShC-ve, që përfshin ndërtimin e kapaciteteve të OShC-ve dhe lëvizjeve bazë rreth tre temave prioritare të këtij veprimi dhe zhvillimin e aftësive të tyre në mënyrë që ata të jenë në gjendje të zbatojnë projekte të duhura, fushata dhe përfaqësojnë interesat të komuniteteve të tyre në mënyrë më efektive. Si një projekt shumë-vjeçar, EEBO ofroi Trajnime për Ndërtimin e Kapaciteteve (CBT) për OJQ-të dhe trajnime mbi menaxhimin e ciklit të projektit. Projekti gjithashtu ofroi ndërgjegjësim midis OJQ-ve të ndryshme në lidhje me situatën e mjedisit në Kosovë, sektorin e energjisë, energjinë e ripërtëritshme por edhe për aspektet e ekonomisë qarkore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Këto sesione trajnimi u mbajtën në 7 qendrat administrative të Kosovës (Ferizaj, Gjakovë, Gjilani, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren). Sesionet e trajnimit u mbajtën në dy module, ku moduli i parë konsistonte në zhvillimin e kapaciteteve, informacione të përgjithshme për mjedisin, sektorin e energjisë dhe ekonominë qarkore. Ndërsa moduli i dytë përbëhej kryesisht nga informacioni në lidhje me menaxhimin e ciklit të projektit. Pas çdo sesioni trajnimi, vlerësimet iu shpërndanë të gjithë pjesëmarrësve në trajnim.

Konkretisht, temat e trajnimit ishin:

1. Përbajtja: Mjedisi, Energjia (Efikasiteti i Energjisë dhe Energjia e Ripërtëritshme) dhe Britja Ekonomike e Gjellbër/Ekonomia Qarkore.
2. **Temat mbështetëse (Moduli 1 - Dita 1):** metodat ndërvepruese dhe pjesëmarrëse për zbatimin e konsultimeve dhe debateve me qytetarët, kryerjen e hulumtimeve, planifikimin dhe zbatimin e punës së avokimit, komunikimin dhe punën me autoritetet publike, shtrirjen inovative, punën me media, investime në shkallë të vogël, etj
3. **Temat organizative (Moduli 2 - Dita 2):** qeverisja dhe menaxhimi i brendshëm, funksionimi transparent, planifikimi strategjik, shpërndarja dhe promovimi, fushata, komunikimi, strategjitë e financimit të qëndrueshëm, kërkimi i financuesve, planifikimi i projekteve afatgjata, etj.



Fig 12. Sesionet e Trajnimit për Ndërtimin e Kapaciteteve (2018)

Trajnimet kishin për qëllim informimin e përfaqësuesve të organizatave pjesëmarrëse në lidhje me çështjet që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë, rolin e tyre në shoqëri në monitorimin e institucioneve publike, për të promovuar aktivitete që kontribuojnë në përmirësimin e situatës në shoqëri si dhe për të promovuar skemën e granteve që BGF dhe INDEP janë duke ofruar si pjesë të projektit përmes të cilit organizata të ndryshme mund të përfitojnë duke siguruar fonde për aktivitetet e tyre. Në këto trajnime kemi përdorur teknika moderne inovative të ligjëritit dhe prezantimit që përfshijnë pjesëmarrjen proaktive të përfituesve duke përfshirë punën në grup dhe ekip.

Tabela më poshtë shpjegon vendet, datat dhe numrin e pjesëmarrësve në secilën ngjarje:

KOMUNA	DATA	NUMRI I Pjesëmarrësve
1. Ferizaj	25-26.04.2018	22
2. Prishtinë	2-3.05.2018	26
3. Prizren	4-5.05.2018	24
4. Mitrovicë	10-11.05.2018	23
5. Gjakovë	15-16.05.2018	39
6. Pejë	17-18.05.2018	21
7. Gjilan	22-23.05.2018	28
Total:		183

Në fund të implementimit të këtij aktiviteti, më shumë se 180 përfaqësues të OShC-ve ishin të përgatitur dhe të informuar mirë në lidhje me sektorin e zhvillimit të qëndrueshëm, mjetet e avokimit dhe praktikën e monitorimit në përmirësimin e situatës në komunitetin/komunën/rajonin e tyre apo edhe në shkallë vendi. Qëllimi i përgjithshëm ishte që të ketë pjesëmarrje proporcionale nga secila komunë e Kosovës, dhe një shumëllojshmëri e OShC-ve, diçka që ky projekt arriti ta kryej me sukses.

Për më tepër, me qëllim për të kontribuar në fuqizimin e OShC-ve dhe përmirësimin e njohurive të tyre, BGF dhe INDEP organizuan trajnime pro-bono për OShC-të përfituese nga thirrja e 2-të dhe e 3-të. Në krahasim me trajnimet e organizuara gjatë vitit të parë të zbatimit të projektit, trajnimet e mëposhtme u ndryshuan në përmbajtje duke marrë parasysh se nga vizitat monitoruese të organizatave të dhëna në thirrjen e parë, BGF dhe INDEP vunë re shumë pasiguri dhe pengesa gjatë gjithë ciklit të implementimit të projektit të tyre. Prandaj, këto trajnime u përdorën për të adresuar saktësisht se nga përbëhet zbatimi i projektit dhe për t'iu përgjigjur çdo pyetje të drejtpërdrejtë që OJQ-të kishin në lidhje me projektet e tyre përkatëse dhe zbatimin e tyre.

Gjatë këtyre trajnimeve OShC-të përfituese brenda skemës së granteve kishin mundësinë të njiheshin me të gjitha çështjet procedurale në lidhje me zbatimin e granteve, si p.sh. kërkesat narrative dhe ato të raportimit financiar, praktikën më të mirë të menaxhimit të projektit etj. Trajnimi gjithashtu informoi përfaqësuesit e organizatave pjesëmarrëse në lidhje me çështjet që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë, rolin e tyre në shoqëri në monitorimin e institucioneve publike, duke vënë theksin në rëndësinë e promovimit të aktiviteteve që kontribuojnë në përmirësimin e situatës në shoqëri.




Fig 13. Sesiione trajnimi për ngritjen e kapaciteteve (2019, 2020)

Trajnimet u ndanë në tri pjesë të diskutimit, ku gjatë pjesës së parë pjesëmarrësit patën mundësinë të mësonin në lidhje me menaxhimin e duhur të ciklit të projektit. Pjesa vijuese përfshiu shpjegime në lidhje me udhëzimet financiare për zbatimin e projektit, dhe së fundmi udhëzime mbi raportimin tregues dhe zbatimin e projektit.

Pas çdo prezantimi, ishte një pjesë e pyetjeve dhe përgjigjeve, ku secili pjesëmarrës kishte mundësinë të bënte pyetje ose të kërkonte sqarime që ishin të zbatueshme për organizatën e tyre ose idenë e projektit.

V. KOMPONENTA E KATËRT: NGJARJA PROMOVUESE

Me qëllim të portretizimit të sukseseve dhe ndikimit të komunitetit që rrjedhin nga projekti EEBO, BGF dhe INDEP organizuan një ngjarje promovuese e cila u organizua në kuadër të Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës (KSDW), një ngjarje e nivelit të lartë ku partnerët e projektit ishin organizatorët kryesorë². Qëllimi i kësaj ngjarje ishte të theksojë rëndësinë e mbështetjes së veprimeve konkrete të OShC-ve lokale në fushën e mbrojtjes së mjedisit, energjisë së gjelbër dhe ekonomisë qarkore - veprime të cilat drejtohen drejtpërdrejt në kontributin e tyre në përmirësimin e komunitetit. Për më tepër, ngjarja synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe mirëkuptimin nga popullata e gjerë në lidhje me rëndësinë e miratimit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë përmes shtrirjes dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimin të publikut.



Fig 14. Ngjarja e vizibilitetit

² <https://www.balkangreenfoundation.org/en-us/press/126/empower-engage-build-ownership-supporting-csos-role-for-a-greener-kosovo/>

Ricardo Serri, Zëvendës Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë / EUSR ishte pjesë e veprimtarisë dhe deklaroi se “Zyra e BE-së në Kosovë ka forcuar mbështetjen për OJQ-të lokale në të gjithë Kosovën përmes projekteve të ngjashme me EEBO; andaj, partneriteti dhe përfshirja e partnerëve nga të gjitha nivelet është thelbësore”. Z. Serri shtoi se bashkëpunimi me OShC-të në Kosovë përputhet me rolin e Bashkimit në promovimin e praktikave më të mira dhe avancimin e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm.

Partnerët e projektit pasqyruan progresin e bërë me zbatimin e projektit deri në pikën e ngjarjes, dhe theksuan promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe vlerave demokratike evropiane si rezultat i projektit EEBO. Kjo ngjarje ishte një platformë për të paraqitur ndikimin që rrjedh nga projekti dhe rezultatet pozitive që arriti. Ngjarja promovoi mesazhin se zhvillimi i qëndrueshëm duhet të jetë një parim udhëzues dhe se ekziston një potencial i madh për ekonominë e Kosovës për të përfituar shumë nga iniciativa të tilla, thjesht duke e promovuar atë përmes mjeteve të duhura dhe duke mbështetur projektet e duhura.



V.1. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

Një objektiv kryesor i projektit EEBO ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimit të qytetarëve në lidhje me rëndësinë e miratimit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Ndër aktivitetet e projektit brenda EEBO, por edhe midis atyre të përfituesve, u theksua komponenti i ndërgjegjësimit.

Një metodologji ndihmëse e cila mundësoi një shtrirje më të lartë të audiencës ishte të qenit i pranishëm në media dhe të shpaloseshin sukseset e projektit. Projekti EEBO mori një mbulim të kënaqshëm mediatik, duke shfaqur thelbin e projektit, por gjithashtu edhe duke promovuar aktivitetet e zbatuara të projekteve nga përfituesit e skemës së granteve. Partnerët e projektit dhe përfituesit e granteve ishin të gatshëm jenë të pranishëm në media me qëllimin për të arritur një audiencë më të gjerë në mënyrë të nxitjes së diskutimeve në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Një numër kanalesh kryesore televizive dhe radio stacionesh kanë pritur përfaqësuesit e ekipit të projektit të cilët përmes emisioneve të ndryshme kanë ndarë informacione rreth projektit në përgjithësi. Për më tepër, partnerët e projektit dhe grantistët shfrytëzuan mediat sociale për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të shfaqur aktivitetet e projektit, dhe për të arritur një grup të synuar të fokusuar, ne gjithashtu kemi angazhuar në promovimin e postimeve në Facebook në aktivitete të caktuara të projektit.

Për më tepër, vlen të përmendet se si një komponentë tjetër e ndërgjegjësimit, përfituesit zbatuan aktivitete të cilat përfshinin një gamë të gjerë materialesh promovuese, si p.sh. postera, prezantime, afishe, broshura, etj., të cilat gjithashtu u shpërndanë për publikun në rrugë. Për më tepër, aktivitetet e projektit të zbatuara nga grantistët përfshinin leksione në disa shkolla fillore dhe të mesme në mënyrë që të informonin nxënësit (të rinjtë) mbi çështjet tematike brenda EEBO.



Fig 15. Paraqitja mediatike e stafit të projektit (KTV)



Fig 16. Aktiviteti i projekteve përfituese (Klan Kosova)

VI. REZULTATET E VEPRIMIT

Zhvillimi i qëndrueshëm, pavarësisht se është koncept mjaft modern në vendin tonë, është përpunuar shumë nga institucionet ndërkombëtare dhe gjithashtu përfshin një pjesë të moderuar të politikave qeveritare. Ndërsa implementimi i zhvillimit të qëndrueshëm është larg nivelit të kënaqshëm, interesi i palëve nuk ka munguar. Siç është elaboruar më lart, ekziston një pjesë shumë e mirë-vendosur e sektorit të OShC-ve që promovon zhvillim të qëndrueshëm dhe të dy organizatat, ku BGF dhe INDEP janë katalizatorë të tij.

Çfarë ne mund të vërtetojmë nga projekti është se shoqëria në përgjithësi, institucionet publike dhe shoqëria civile në Kosovë janë të interesuar të bëjnë reformat e nevojshme për integrimin në BE, në veçanti ato që kanë të bëjnë me demokracinë pjesëmarrëse dhe angazhimin civil, si dhe zbatimin e nevojës për rritjen e qëndrueshme dhe ruajtjen e mjedisit. Si rezultat, ky projekt u ndërtua në faktin se OShC-të në Kosovë kanë nevojë për ndërtim të mëtejshëm të kapaciteteve për angazhimin qytetar në tri tema të këtij veprimi përmes shkëmbimit të përvojës, dhe janë të motivuar për të fituar aftësi në hartimin e projekteve si dhe zhvillimin dhe promovimin e tyre.

Ky projekt dëshmoi të ishte shumëdimensional: ku kontribuoi në rritjen e kapaciteteve ndërmjet OShC-ve në monitorimin e institucioneve publike si dhe promovoi zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke mbështetur aktivitetet e projektit. Gjatë zbatimit të aksionit kishte shumë aktorë të përfshirë nga spektra dhe nivele të ndryshme. Për shkak të fuqizimit dhe mbështetjes së ofruar për OShC-të si rezultat i këtij veprimi, projekti ka kontribuar në krijimin e institucioneve publike më transparente, efikase dhe të qëndrueshme; dhe OShC-të e afta për të hartuar, zbatuar projekte të ndryshme dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi potencialin e zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës. Për më tepër, ky veprim mbështeti projekte të cilat shërbyen si frymëzim edhe për grupe të tjera.

Zbatimi i secilit aktivitet brenda këtij veprimi ka kontribuar në një demokraci më të fortë pjesëmarrëse dhe angazhim të qytetarëve në Kosovë. Për më tepër, për faktin se çdo vit, rreth 18 organizata zbatuan projekte që në fokusin e tyre kishin zhvillim të qëndrueshëm, ky sektor më në fund mori vëmendjen e tij të nevojshme nga të gjithë aktorët.

Raporti i Vlerësimit që u publikua në kuadër të projektit identifikoi problemet dhe potencialin brenda tre fushave tematike dhe rekomandimet konkrete për institucionet përkatëse në mënyrë që të përmirësohet situata në terren. Si rezultat i trajnimeve për ndërtim të kapaciteteve, më shumë se 180 përfaqësues të OShC-ve kanë përfituar aftësi në zhvillimin e veprimeve të tyre të planifikuara në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm si një nxitës për të rritur rritjen e gjelbër ekonomike duke përdorur sa më pak energji elektrike dhe duke e ruajtur mjedisin. Rrjeti që u krijua midis OShC-ve nga vende të ndryshme, institucione kombëtare dhe lokale është një shenjë pozitive e një bashkëpunimi me shumë aktorë. Skema dhe materialet e granteve pritet të kenë një jetë përtej projektit. Por gjithashtu, aftësitë e fituara do të ndihmojnë zhvillimin afatgjatë dhe angazhimin e qytetarëve.

BGF dhe INDEP monitoruan dhe këshilluan organizatat gjatë gjithë implementimit të projektit dhe ofruan platformat e tyre të avokimit dhe rrjetëzimit - jo vetëm me organizatat kombëtare por edhe me ato rajonale dhe ndërkombëtare. Këto rrjete zakonisht sjellin mundësi për zbatimin e përbashkët të projektit. Pjesëmarrësit e të gjitha aktiviteteve ishin, dhe do të vazhdojnë të jenë, pjesë e Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës, një ngjarje që BGF dhe INDEP janë partnerët thelbësorë - të cilët mblodhën palët e interesuara, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe organizatave, por edhe të institucioneve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, për të diskutuar zhvillimet brenda fushës së zhvillimit të qëndrueshëm.

VII. PROGRESI NË FUSHËN E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË KOSOVË

Kosova është ende mbrapa në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Arritja e progresit në këtë fushë kërkon veprim në të gjitha frontet - qeveritë, bizneset dhe shoqërinë civile. Mbështetja e përfituesve të vegjël dhe lehtësimi i OShC-ve që të specializohen në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në përgjithësi është një faktor kryesor në rrugën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm socio-ekonomik. Ka një mungesë të politikave vizionare të zhvillimit që prekin fushat kryesore si energjia, mjedisi, ekonomia, shëndetësia dhe aspektet sociale. Kosova ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm.

Kosova ka filluar vullnetarisht të adaptojë dhe integrojë Agjendën 2030, një plan universal veprimi që synon të zhdukë varfërinë, të mbrojë planetin dhe të sigurojë prosperitet kudo. Hapat e parë drejt përbushjes së kësaj Agjende janë ndërmarrë duke krijuar „Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm“. Institucionet e Kosovës janë gjithashtu të angazhuara për ndërtimin e një shoqërie më paqësore, gjithëpërfshirëse dhe të prosperuar - siç parashihet nga Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG) - duke pranuar se mënyra e vetme për ta arritur këtë është duke punuar së bashku me të gjithë palët e interesuara. Në Kosovë, të gjitha nivelet e qeverisjes, qytetarët, shoqëria civile dhe sektori privat, luajnë një rol në avancimin e SDG-ve duke siguruar që askush të mos mbetet pas. Një zhvillim i qëndrueshëm mund të arrihet vetëm nëse të gjithë janë pjesëmarrës.

Që nga fillimi i tij, veprimi Empower-Engage-Build Ownership ishte në sinergji me përparësitë e BE-së për demokratizimin e shoqërisë, për sigurimin e mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe për veprime për të ndihmuar Kosovën të përballlet me sfidat e Integritimit Evropian.

Ky projekt ka treguar të jetë një mjet theksues duke shfaqur se zhvillimi i qëndrueshëm duhet të jetë një parim udhëzues, duke marrë parasysh potencialin e madh që ekonomia e Kosovës të përfitojë nga iniciativat që fuqizojnë organizatat e shoqërisë civile thjesht duke promovuar mjetet e duhura dhe duke mbështetur projektet e duhura. Shoqëria civile ka forcuar vazhdimisht kapacitetin e saj për të qenë një aktor kryesor dhe si një mekanizëm i madh shtytës në ngritjen e vetëdijes dhe duke shërbyer si një urë midis njerëzve dhe institucioneve në adresimin e nevojave dhe avancimin e dialogut publik. Më e rëndësishmja, projekti ka kontribuar në ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme për fushën e zhvillimit të qëndrueshëm duke nxitur ndryshimet shoqërore, forcimin e komuniteteve, fuqizimin e studentëve dhe edukimin e fëmijëve.

SHTOJCA A:

LISTA E ORGANIZATAVE PËRFITUESE TË SKEMËS SË NËN-DHËNIES EMPOWER-ENGAGE-BUILD OWNERSHIP

ORGANIZATA PËRFITUESE	PROJEKTI	SHUME
1. Dokufest	Kino Solare	14,960.00 EUR
2. Innovation Centre Kosovo - ICK	Partneriteti Ndërsektorial për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe EE.	15,000 EUR
3. Ta Pastrojmë Kosovën Let's Do It)	Le ta Gjellërojmë	14,982.65 EUR
4. CEDE-Center for Education and Development of Environment	"Promovimi i kompostimit në shkolla dhe ekonomi familjare"	4,996.00 EUR
5. Keep it Green	"Kameri diellor"	4,996.00 EUR
6. KosovaLive	Eko-Dizajnimi i së Ardhmës	4,930.00 EUR
7. NVO Bolja Budućnost	Komuna më e pastër Klokot-Vrbovac	4,935.00 EUR
8. Youth Association for Human Rights	"Ne mund ta bëjmë atë për mjedisin tonë të jetesës!"	4,920.00 EUR
9. Youth Ecological and Security Zone - EcoZ	"Më pak është më shumë"	4,870.00 EUR
10. Poslovni Centar Zvečan	"Riciklimi i mbeturinave - Modele të reja"	4,998.00 EUR
11. Human Center Mitrovica	Për Liqenin e Pastër	4,995.00 EUR
12. Instituti për Zhvillim dhe Integrim - IZHI	"Ruajtja e ambientit, ruajtje e shëndetit"	4,995.00 EUR
13. Agricultural Recovery - REB	"Mbrotja e ambientit nga ndotja me biombeturina- Kompostimi"	4,990.00 EUR
14. OJQ 7Arte	"Festivali e Gjellë"	5,000.00 EUR
15. Zelena Basta (Green Garden Association)	"Rritja e ndërgjegjësimin për një botë më të pastër"	4,430.00 EUR
16. Jakova Innovative Center - JIC	"Koshi i zgjuar"	5,000.00 EUR
17. Qendra Rinore "Ardhmëria-Klinë"	Edukimi mjedisor	5,000.00 EUR

ORGANIZATA PËRFITUESE	PROJEKTI	SHUME
18. Edukimi për energji dhe Ambient (3E)	Park i jashtëm shahu për komunitetin e Gjakovës	4,700.00 EUR
19. Vizionida	Hartimi dhe aprovimi i rregullores Komunale për menaxhimin e grumbullimit të mbeturinave	4,903.00 EUR
20. Media Center	“Pastërtia është shëndet”	4,000.00 EUR
21. Association of Architects	“Zhvillimi i qëndrueshëm dhe inovativ i ndërtimit dhe industria e pasurive të patundshme në Kosovë”	14,970.00 EUR
22. Endemika	Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për pjesëmarrje në procesin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit	4,000.00 EUR
23. NGO Media Pulse	Leposavic - I pastër dhe i gjelbër	3,998.00 EUR
24. NGO Ozon	Pesticidet, rreziku i përbashkët	3,945.00 EUR
25. SBUNKER	BasketShishe	4,000.00 EUR
26. GAIA	Ndërtimi me natyrën në mendje	3,994.00 EUR
27. EKOVIZIONI	Jetoni gjelbër, Ruaj gjelbrimin	4,000.00 EUR
28. Young Active Gračanica	Gračanica Tourism Bike Rental	4,000.00 EUR
29. AYA Pjeter Bogdani	Biçikleta, qyteti dhe unë	4,000.00 EUR
30. NGO Center for Lifelong Learning Lighthouse	Ruaj Planetin për Rini	3,915.00 EUR
31. Fryma e re Europiane	EcoCharge	3,979.00 EUR
32. Shoqata ekologjike „Ambienti,, (SHEA)	Trajtimi ekologjik i mbetjeve	4,000.00 EUR
33. OJQ Environment & Community Development	Ambienti në të cilin jetojmë është shtëpia jonë	4,000.00 EUR
34. OJQ Shpresa e Jetes	Udhëheqësit e Ardhshëm të Gjelbër	4,000.00 EUR
35. Non-governmental Organization THY	“Ripërdorimi” Përdorim më i mirë!	4,000.00 EUR
36. NGO-SHQIPONJA	Filtrimi mjedisor Prizren	3,980.00 EUR
37. GLPS	Forcimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në ngritjen e vetëdijes së institucioneve për rëndësinë e standardeve të acquis dhe miratimin e tyre në legjislacionin e Kosovës ‘	14,230.00 EUR
38. Womens Bussines Association - SHE-ERA	“Prodhimi i plehut organik me konceptin e ekonomisë rrethore si një burim i sigurt i qëndrueshëm në Kosovë”	14,860.00 EUR

ORGANIZATA PËRFITUESE	PROJEKTI	SHUME
39. Green Project	Riciklimi - E ardhmja ekologjike	3,905.00 EUR
40. Varg e Vi	Ecje e Shendetshme!	4,900.00 EUR
41. NGO Roma Road	Natyra është miku ynë	4,900.00 EUR
42. Youth Center Lipjan	Më shumë larami, shoqëria më e mirë	4,900.00 EUR
43. Center for Education and Development of Environment	Shoqëri aktive për mjedis të pastër	4,900.00 EUR
44. Education Comes First	Krijimi i plehut organik	4,890.00 EUR
45. Iniciativa për Zhvillim Lokal	Menaxhimi i mbeturinave dhe mbrojtja e mjedisit përmes të rinjve në komunën e Obiliqit	4,890.00 EUR
46. Bashkimi Rinor E Ardhmja E Nditur – BRAN	Plani i Avokimit dhe Veprimt për një Shtime më të mirë dhe më të gjelbër	4,880.00 EUR
47. Keep it Green	Ricikleta	4,822.00 EUR
48. Dedicated, Determined and Disciplined youth-D3 Youth	Lidhja e njeriut me natyrën	4,900.00 EUR
49. Omladinski savet Gračanica (OSG)	Ajri i Pastër Gračanica	4,890.00 EUR
50. Klubi Albin Prishtina	Ciklizmi i sigurt në Prishtinë	4,890.00 EUR
51. Shoqata për ngritjen e vlerave shoqërore, edukative dhe morale, “Universi”	Ngritja e kapaciteteve të lidershit lokal drejtë planifikimit më të mirë ambiental në Dragash	4,745.00 EUR
52. Vijece Kongresa bosnjackih intelektualaca	Spreçimo izgradnju mini hidroelektrana u Župi – Nacioanlni park Sar planina	4,860.00 EUR
53. Agjencia për Zhvillim Rajonal – Lindje	Duane Liqenin Tuaj	4,880.00 EUR
54. Eco Motiv	Ekologji krijuese - ndryshoni zakonet tuaja, mos ndryshoni natyrën tuaje	4,820.00 EUR
55. Advocacy Center for Democratic Culture – ACDC	Ruaj të ardhmen e fëmijëve tanë	4,659.00 EUR
56. NVO 4Life	Cuvajmo ono sto smo pozajmili od mladih	4,995.00 EUR
57. Eficiencë & Auditim i Energjisë (EAE – Cooperation)	Parkingu solar	15,020.00 EUR

ORGANIZATA PËRFITUESE	PROJEKTI	SHUME
58. Democracy Plus	Angazhimi i të Rinjve për Mbrojtjen e Mjedisit nga Mbeturinat	14,970.00 EUR
59. Free Libre Open Source Software Kosova –FLOSSK	“Stacionet e sensorit”	14,700.00 EUR

Tabela 3. Lista e organizatave përfituese të skemës së nën-dhënies ‘Empower-Engage-Build Ownership’

SHTOJCA B: TRAJNIMET DHE SESIONET INFORMUESE

Sesionet e Trajnimeve për Ndërtimin e Kapaciteteve u mbajtën në 7 qendrat administrative të Kosovës (Ferizaj, Gjakovë, Gjilani, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren)

Tabela më poshtë shpjegon vendet, datat dhe numrin e pjesëmarrësve në seancat trajnuese.

KOMUNA	DATA	NUMRI I PJESËMARRËSVE	NUMRI I ORGANIZATAVE
1. Ferizaj	25.04.2018	10	7
2. Prishtinë	02.05.2018	15	14
3. Prizren	04.05.2018	12	10
4. Mitrovicë	10.05.2018	12	10
5. Gjakovë	15.05.2018	20	17
6. Pejë	17.05.2018	11	10
7. Gjilan	22.05.2018	18	12
Total:		98	183

Moduli 2

KOMUNA	DATA	NUMRI I PJESËMARRËSVE	NUMRI I ORGANIZATAVE
1. Ferizaj	26.04.2018	12	7
2. Prishtinë	03.05.2018	11	13
3. Prizren	05.05.2018	12	12
4. Mitrovicë	11.05.2018	11	10
5. Gjakovë	16.05.2018	19	16
6. Pejë	18.05.2018	10	9
7. Gjilan	23.05.2018	10	10
Total:		85	77

Tabela më poshtë shpjegon vendet, datat dhe numrin e pjesëmarrësve në sesionet informuese për thirrjen e parë për aplikime që u zhvilluan nga 5-14 qershor 2018.

KOMUNA	DATA	NUMRI I PJESËMARRËSVE
Prizren	05.06.2018	20
Gjilan	06.06.2018	18
Pejë	07.06.2018	11
Mitrovicë	11.06.2018	16
Gjakovë	12.06.2018	23
Prishtinë	13.06.2018	24
Ferizaj	14.06.2018	14
Total:		126

Tabela më poshtë shpjegon vendet, datat dhe numrin e pjesëmarrësve në sesionet informuese për thirrjen e dytë për aplikime që u mbajtën ndërmjet datave 18-28 Mars, 2019.

KOMUNA	DATA	NUMRI I PJESËMARRËSVE
Prizren	18.03.2019	24
Pejë/Peç	19.03.2019	26
Gjakovë/Đakovica	19.03.2019	13
Ferizaj/Uroševac	20.03.2019	19
Mitrovicë/a	21.03.2019	50
Prishtinë/a	22.03.2019	48
Gjilan/Gnjilane	25.03.2019	32
North Mitrovica	28.03.2019	7
Total:		219

Tabela më poshtë shpjegon vendet, datat dhe numrin e pjesëmarrësve në sesionet informuese për thirrjen e 3-të të hapur për aplikime që u zhvilluan ndërmjet datave 2-11 tetor 2019.

KOMUNA	DATA	NUMRI I PJESËMARRËSVE
Gjilan/ Gnjilane	2 Tetor 2019	21
Ferizaj/Uroševac	3 Tetor 2019	30
Gjakova/ Đakovica	4 Tetor 2019	33
Mitrovicë/a	8 Tetor 2019	26
Prizren	10 Tetor 2019	35
Peja/Peç	11 Tetor 2019	28
Prishtina/ Priština	11 Tetor2019	23
Total:		196

SHTOJCA C: FOTOGRAFITË ME PËRFITUESIT E GRANTEVE

Fotografi nga disa prej aktiviteteve të grantistëve të projektit.





INFORMACIONE BAZË MBI PARTNERËT E IMPLEMENTIMIT

Rreth BGF

Balkan Green Foundation (BGF) është një organizatë rajonale që promovon progres gjithëpërfshirës dhe të drejt brenda Ballkanit Perëndimor në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Themeluar në vitin 2014, së bashku me organizatat e saj partnere, BGF vendos një fokus të fortë në avokimin për zgjidhjet që promovojnë politikën e zhvillimit, të cilat janë në përputhje me zhvillimet e fundit në botë, sfidat globale dhe agjndat kombëtare për integrimin në BE. Nismat rajonale ndërmerren në mënyrë të vazhdueshme për të përcjellë më tej angazhimin e BGF drejt qëndrueshmërisë rajonale, duke siguruar forcimin dhe avancimin e politikave vitale që prekin sektorët kryesorë, siç janë energjia, mjedisi dhe ekonomia. BGF është pozicionuar me sukses si një partner kryesor strategjik për institucionet, organizatat dhe komunitetet rajonale dhe globale në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, transformimin e koncepteve inovative në zgjidhje të fuqishme dhe forcimin e partneriteteve rajonale dhe globale.

Rreth INDEP

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) është një institut kërkimor dhe një qendër avokimi që ofron zgjidhje të pavarura të politikave të bazuara në kërkime. I themeluar në vitin 2011 si një shoqatë e analistëve të politikave, studiuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, INDEP shikon politikën rajonale, që synojnë të drejtojnë vendet e Evropës Jug-Lindore në rrugën e tyre drejt integritit Euro-Atlantik. Në Kosovë, ku është i vendosur, instituti ka një fokus të veçantë në forcimin e qeverisjes demokratike dhe luan rolin e vëzhguesit të politikave publike. Misioni i INDEP është të forcojë dhe drejtojë zhvillimin e qëndrueshëm socio-politik dhe ekonomik bazuar në parimet e demokracisë dhe vlerave demokratike. Vizioni i tij është krijimi i një shoqërie demokratike, e aftë dhe e gatshme për të drejtuar një shtet funksional, të integruar në rajon dhe bashkësinë ndërkombëtare. Puna e INDEP drejtohet nga parimet themelore të transparencës dhe llogaridhënies. Instituti promovon qytetari aktive dhe pjesëmarrje në qeverisje, si dhe kontrolle dhe balance midis institucioneve të zgjedhura në mënyrë demokratike.

MBËSHTETJA E DONATORËVE NDËRKOMBËTARË PËR PROJEKTIN EEBO

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ishte mbështetësi kryesor i këtij projekti, duke mbështetur aktivitete me një ndikim të madh në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Për më tepër, gjatë gjithë zbatimit të projektit, EEBO ka marrë mbështetje nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë, të tillë si Rockefeller Brothers Fund, Heinrich-Böll-Stiftung dhe Fondacioni ERSTE, të gjithë duke vlerësuar projektin pozitivisht duke marrë parasysh ndikimin e tij në përmirësimin e komunitetit dhe fuqizimin e OShC-ve që punojnë në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm.



Ky projekt u bashkëfinancua nga:



Implementuar nga:



